VENDIM
Nr. 42, datë 25.5.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	Anëtar i	"	"
Vitore Tusha	Anëtare e	"	"
Fatmir Hoxha	Anëtar i	"	"
Fatos Lulo	Anëtar i	"	"
Besnik Imeraj	Anëtar i	"	"

me sekretare Belma Lleshi, në datën 16.3.2017, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 8 Akti, që i përket:

KËRKUES: PERIKLI KOLIÇI
SUBJEKT I INTERESUAR: MINISTRIA E MBROJTJES

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimit nr. 00-2015-3668 (569), datë 3.11.2015, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 29, 41, 42, 131/f dhe 134/1/i dhe 134/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Besnik Imeraj, parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:
I

1. Kërkuesi Perikli Koliçi ka marrë titullin "Oficer" në vitin 1982 dhe është graduar "Kolonel" në vitin 2004. Në vitin 2009 ka konkurruar për gradën "Gjeneral brigade" dhe nga komisioni i vlerësimit është renditur i pari me 8,39 pikë. Për rrjedhojë, ai i është propozuar si kandidat ministrit të Mbrojtjes. Ky i fundit, me shkresën e datës 3.9.2009, i ka kërkuar Presidentit të Republikës promovimin me gradën "Gjeneral" të pesë oficerëve të Forcave të Armatosura, ku nuk përfshihej emri i kërkuesit. Pasi ka paraqitur ankim pranë ministrit të Mbrojtjes, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e tij të nxjerrë aktin administrativ (propozim), ku i drejtohet Presidentit për dhënien e gradës madhore "Gjeneral brigade".

2. Me vendimin nr. 4947, datë 9.6.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

3. Me vendimin nr. 723, datë 29.3.2012, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: "*Ndryshimin e vendimit nr. 4947, datë 9.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në këtë mënyrë: Pranimin e padisë. Detyrimin e ministrit të Mbrojtjes që të nxjerrë një akt administrativ në përputhje me ligjin, me qëllim rivendosjen e së drejtës së cenuar të paditësit Perikli Koliçi, në vijim të procesit të gradimit, iniciuar me urdhrin nr. 821, datë 11.6.2009 të ministrit të Mbrojtjes*". Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs Ministria e Mbrojtjes.

4. Me vendimin nr. 00-2015-3668 (569), datë 3.11.2015, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur: "*Prishjen e vendimit nr. 723, datë 29.3.2012, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr.*

4947, datë 9.6.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë".

II

5. ***Kërkuesi Perikli Koliçi*** i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:

5.1. *Është cenuar parimi i sigurisë juridike dhe i pritshmërive të ligjshme* për shkak të mohimit të së drejtës së kërkuesit për të realizuar të drejtat e tij që burojnë nga ligji. Arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë përbën një shtrembërim dhe ndryshim të thelbit të ligjit nr. 9171, datë 22.1.2004, "Për gradat dhe karrierën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Njohja e diskrecionit të pakufizuar ministrit të Mbrojtjes në promovimin në gradë, duke justifikuar veprimet arbitrare të këtij autoriteti për të propozuar një kandidaturë të renditur në fund të listës së konkurrentëve, duke shmangur parimin e konkurrencës dhe të karrierës, është shkelje e parimeve kushtetuese të mësipërme. Kërkuesi është renditur i pari në konkurrim, ndërkohë që diskrecioni i ushtruar nga ministri, duke shmangur renditjen dhe vlerësimin e kryer nga komisioni i vlerësimit, e ka vendosur kërkuesin në pozitë të disfavorshme, duke i mohuar të drejtën e ecurisë në karrierë, pa dhënë asnjë arsye për këtë.

5.2. Ligji në mënyrë të qartë ka vendosur kufizime për të shmangur abuzimet dhe arbitraritetin e një funksionari publik, për sa i takon vlerësimit të performancës së ushtarakëve që konkurrojnë. Ligji nr. 9171/2004 përcakton se kriteri i vetëm ku bazohet ministri i Mbrojtjes për të propozuar kandidaturat është vetëm performanca e ushtarakut, e cila vlerësohet nga komisioni përkatës, i cili shprehet në sasinë e pikëve të grumbulluara nga konkurrimi. Neni 21/a i ligjit parashikon se autoriteti dhe përgjegjësia për vlerësimin e performancës së ushtarakut për të avancuar në gradë i takon komisionit të veçantë të karrierës.

5.3. *Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi vendimi i Kolegjit Administrativ nuk jep argumente që të justifikojnë vendimmarrjen e tij. Gjykata e Lartë nuk ka dhënë asnjë argument kundër dhe asnjë arsyetim për të justifikuar vendimmarrjen. Ajo nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të kërkuesit për abuzimin me diskrecionin nga ana e ministrit dhe në vendim nuk jepen argumente të qarta e të mbështetura në ligj që të përligjin diskrecionin e ministrit.

5.4. *Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm.* Gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është kryer brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 60/2 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon se çështja shqyrtohet brenda afatit 90-ditor. Kërkesëpadia është regjistruar në gjykatën e shkallës së pare, në datën 18.11.2009 dhe gjykimi ka përfunduar në datën 9.6.2011. Në Gjykatën e Apelit çështja është regjistruar në datën 4.8.2011 dhe ka përfunduar në datën 29.3.2012, kurse në Gjykatën e Lartë çështja është regjistruar në datën 13.6.2012 dhe është gjykuar nga Kolegji Administrativ në datën 3.11.2015, duke ndenjur në këtë gjykatë pa u gjykuar për rreth 3 vjet e 5 muaj. I tërë procesi gjyqësor administrativ ka zgjatur 6 vite.

5.5. *Është shkelur parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit.* Vendimi i Gjykatës së Lartë ka ligjëruar shkeljen e parimit të barazisë nga organi i administratës publike. Në kundërshtim me këtë parim, kërkuesit i është cenuar kjo e drejtë gjatë konkurrimit, ndonëse ai ishte renditur i pari në listë, por në mënyrë arbitrare nga ministri është preferuar të përzgjidhen personat e renditur më poshtë në listë apo dhe jashtë listës të rekomanduar nga komisioni i vlerësimit.

5.6. *Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.* Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duke cenuar parimin e sigurisë juridike, të barazisë para ligjit, të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm dhe duke mos respektuar detyrimin për dhënien e një vendimi të arsyetuar, nuk ka plotësuar standardin për të qenë një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

6. ***Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes,*** në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar këto argumente para Gjykatës:

6.1. Kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materia*, pasi pretendimet e ngritura prej tij në kërkesë kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe të interpretimit të ligjit.

6.2. Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i pabazuar, pasi nuk është arritur të ngrihet në nivel kushtetues. E vetmja detyrë e komisionit sipas ligjit është përcaktimi i ushtarakëve që plotësojnë kriteret ligjore për avancim në gradë dhe rekomandimin e këtyre emrave ministrit të Mbrojtjes.

6.3. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë. Referuar vendimit të Kolegjit Administrativ rezulton se në pjesën hyrëse ai përmban palët ndërgjyqëse, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të Apelit, si dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs subjekti i interesuar.

6.4. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak të mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, është fakt se ngarkesa e madhe e çështjeve si në gjykatat më të ulëta, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë ka sjellë shtyrjen në kohë të shqyrtimit të kësaj çështjeje.

6.5. Në lidhje me pretendimet për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, kërkuesi nuk ka paraqitur argumente për të mbështetur këto pretendime.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

7. Çështja e legjitimimit (*locus standi)* të subjekteve që i drejtohen kësaj Gjykate është vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, në kuptim të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

8. Në lidhje me legjitimimin *ratione materia*, në jurisprudencë konstante Gjykata ka theksuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli që ajo ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave. Interpretimi i ligjit, duke përcaktuar përmbajtjen e tij, është atribut i organeve që e zbatojnë atë dhe nisur nga ky parim, sqarimi i kuptimit apo interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor (*shih vendimet nr. 23, datë 17.5.2011; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 4, datë 5.2.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka plotësuar standardin për të qenë një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Gjykata ka theksuar se procesi i gjykimit kushtetues është i natyrës argumentuese, që nënkupton se u takon palëve të parashtrojnë argumentet faktike dhe ligjore mbi të cilat mbështesin pretendimet e tyre. Është detyrë e palëve të shpjegojnë arsyet të cilat kanë çuar, sipas këndvështrimit të tyre, në shkelje të Kushtetutës, dhe më konkretisht të procesit të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, kërkuesi nuk ka arritur të sjellë argumente të mjaftueshme për të argumentuar pretendimin e mësipërm për cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materia* në lidhje me pretendimin e mësipërm, pasi është haptazi i pabazuar.

10. Në lidhje me pretendimin për mosgjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se në bazë të neneve 131/f dhe

134/1/i të Kushtetutës, individi legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 14, datë 10.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

11. Sipas kërkuesit është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ nuk jep argumente që të justifikojnë vendimmarrjen e tij. Gjykata e Lartë nuk ka dhënë asnjë argument kundër dhe asnjë arsyetim për të justifikuar vendimmarrjen dhe nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuara pretendimeve të kërkuesit për abuzimin me diskrecionin nga ana e ministrit.

12. Sipas subjektit të interesuar, vendimi i Kolegjit Administrativ plotëson të gjitha kriteret e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe jurisprudencës kushtetuese.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban Gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij, ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimin nr. 63, datë 23.9.2015, të Gjykatës Kushtetuese).*

15. Në kuptim të sa më sipër nuk rezulton se vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk përmbushë elementet si më sipër. Ai përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si edhe ka parashtruar në pjesën arsyetuese argumentet ku mbështet që ndrimin e tij të shprehur në dispozitiv. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm

16. Sipas kërkuesit, gjykimi në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë nuk është kryer brenda afatit ligjor 90-ditor të përcaktuar në nenin 60/2 të ligjit nr.49/2012. Kërkesëpadia është regjistruar në gjykatën e shkallës së pare, në datën 18.11.2009 dhe gjykimi ka përfunduar në datën 9.6.2011. Në Gjykatën e Apelit çështja është regjistruar në datën 4.8.2011 dhe ka përfunduar në datën 29.3.2012, kurse në Gjykatën e Lartë është regjistruar në datën 13.6.2012 dhe është gjykuar nga Kolegji Administrativ në datën 3.11.2015, duke ndenjur në këtë gjykatë pa u gjykuar për rreth 3 vjet e 5 muaj. I tërë procesi gjyqësor administrativ ka zgjatur 6 vjet.

17. Sipas subjektit të interesuar, ngarkesa e madhe e çështjeve si në gjykatat më të ulëta, ashtu

edhe në Gjykatën e Lartë ka sjellë shtyrjen në kohë të shqyrtimit të kësaj çështjeje. Rezulton se ka një arsye objektive pse është shtyrë në kohë shqyrtimi i saj dhe nuk ka pasur në asnjë moment sjellje të njëanshme të autoriteteve shtetërore në dëm të interesave të kërkuesit.

18. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjithashtu, Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeja e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeja e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (shih *vendimin nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të arritur në përfundimin nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Gjykata vlerëson se duhet të merret në analizë secili prej elementeve të sipërcituara.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

20. Lidhur me periudhën e *kohës që duhet marrë në konsideratë,* nga materialet bashkëlidhur kërkesës dhe të dhënat në faqen zyrtare *web* të Gjykatës së Lartë rezulton se çështja në shqyrtim është regjistruar në atë gjykatë në datën 13.6.2012, kurse gjykimi në Kolegjin Administrativ është bërë në vitin 2015, ndonëse neni 60/2 i ligjit nr. 49/2012 parashikon afatin prej 90-ditësh për shqyrtimin e çështjes nga kjo gjykatë. Për rrjedhojë, shqyrtimi i çështjes në Gjykatën e Lartë rezulton të ketë zgjatuar për një periudhë rreth 3 vjet e gjysmë.

ii. Kompleksiteti i çështjes

21. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme *(shih vendimin nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative, gjykimi i të cilave parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative". Çështja në shqyrtim ka për objekt detyrimin e një organi për nxjerrjen e aktit administrativ, për rrjedhojë ajo nuk paraqet kompleksitet që mund të justifikonte vonesa në shqyrtimin e saj nga Kolegji Administrativ, ndaj vlerësimi i sjelljes së autoriteteve publike dhe të kërkuesit është me rëndësi në këtë kontekst.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkuesit

23. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuesit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata çmon se kërkuesi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv. Sjellja e autoriteteve

24. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve

për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së, i cili thotë: "*Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme"*, dhe në nenin 171/a të KPC-së, që thotë: "*Gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj"* (*shih vendimin nr. 45, datë 19.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka konstatuar se neni 3 i ligjit nr. 49/2012 ndër parimet e gjykimit administrativ ka përcaktuar garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësit në krijimin e këtyre gjykatave. Përderisa ligjvënësi ka përcaktuar këto afate kohore (90 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t'u zbatuar nga gjykatat administrative. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se justifikimi në çështje të ngjashme se shkak i vonesës në shqyrtimin e çështjes është numri i lartë i çështjeve në ngarkim të këtyre gjykatave, nuk është i bazuar. Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Në të kundërt, është detyrë e këtij të fundit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatë të Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pretendimi i subjektit të interesuar se shtyrja në kohë e shqyrtimit të çështjes është bërë për shkak të ngarkesës së çështjeve, është i pabazuar.

27. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm është i drejtë dhe duhet pranuar.

D. *Për pretendimet e tjera*

28. Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe pritshmërive të ligjshme, si edhe të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, në thelb i referohen mënyrës së zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë dhe nuk janë ngritur në nivel kushtetues. Duke qenë me natyrë ligjore dhe jo kushtetuese, zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, por i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm.
- Rrëzimin e kërkesës për pretendimet e tjera.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj,
Anëtar pjesërisht kundër[1]: Vitore Tusha

[1] Gjyqtarja V. Tusha ka votuar kundër konstatimit të cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda një afati të arsyeshëm.